



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2020:096579
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05602946

K.Dh.Sh.II.nr.1158/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Zeni Com” me seli në Kamenicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati S.S. nga Kamenica, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1342/20 të datës 11.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Zeni Com me seli në Kamenicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1342/20, i datës 11.11.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1342/20, të datës 11.11.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Zeni Com” nga Kamenica, ndërsa ka mbetur në fuqi vendimi nr.167/2020 i datës 04.08.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja t’i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë, apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.167/2020, të datës 04.08.2020, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.167/2020 të datës 04.06.2020 për subjektin “Zeni Com” me pronar z.Z.I., me adresë në rrugën “Malësia” – Kamenicë në mbështetje të nenit 85 të Ligjit nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, deri në përfundimin e procedurës penale të paraqitur në Prokurorinë Themelore.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 13.08.2020, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.167/2020, të datës 04.08.2020, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar ka theksuar se në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, Gjykata me Aktgjykimin A.nr.783/17 dt.15.01.2020 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar vendimin nr.95/2017 dt.06.04.2017 i ATK-së dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata ka kërkuar nga e paditura në rivendosje që të deklarohet se mbi cilën bazë e ka ngarkuar paditësin me detyrime tatimore për periudhën 02/2016, të deklarohet se cilat janë ato informata-përgjime, kush është përgjuar, dhe të njëjtat prova të paraqiten si të transkriptuara në procedurën gjyqësore, e paditura të deklarohet rreth faturës 01.01.7700 dt.19.02.2016, kush e ka lëshuar këtë faturë të blerjes. E paditura në rivendosje me vendimin kontestues ka pezulluar përkohësisht shqyrtimin e ankesës së paditësit deri në përfundimin e procedurës penale, me arsyetimin se nuk ka mund të siguroj provat e transkriptuara që gjenden në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, andaj lëndën e ka pezulluar në bazë të nenit 85 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Nga kjo gjendje aktuale ku e paditura në procedurën e ankesave nuk ka mund të deklarohet lidhur me vërejtjet e Gjykatës, për shkak se i njëjti rast ndaj paditësit është duke u vazhduar procedura penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, dhe nuk ka qenë e mundur tani të sigurohen si prova transkriptet për të filluar shqyrtimin e ankesës së paditësit, gjykata në procedurën e konfliktit administrativ e konsideron si vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e të paditurës me të cilin është pezulluar përkohësisht shqyrtimi i ankesës së paditësit nr.167/2020 dt.04.06.2020. Gjykata nga administrimi i provave nuk posedon asnjë provë nga palët ndërgjyqëse, për ti vërtetuar provat gjatë procedimit administrativ, Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll nuk gjenden në lëndë, nuk janë shqyrtuar as nga e paditura provat-transkriptet që dëshmojnë qarkullimin shesë me të cilin është ngarkuar paditësi për periudhën tatimore 02/2016 me faturën 01/01/7700 dt.19.02.2016. Prandaj në mungesë të provave që kanë ndikim vendimtar lidhur me deklarin tatimor të padeklaruar të paditësit, gjykata nuk ka mund të vendos një gjendje tjetër faktike, sepse as gjykata nuk i posedon këto prova materiale transkriptet-përgjimet e siguruara në procedurën penale. Nga të gjitha provat e administruara, gjykata konstaton se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka pezulluar përkohësisht shqyrtimin e

ankesës, duke u bazuar në dispozitën e nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që parasheh: Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për aplikim të gabuar të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që me rastin e marrjes së aktgjykimit, gjykata vetëm i ka përshkruar vërejtjet tona, por nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete pse nuk i ka aprovuar pretendimet tona, por ia ka falur besimin Vendimit 167/2020 të nxjerrë me datë 04.08.2020, i cili ka qenë i pasafatëshëm. Këtë pretendim kolegji i kësaj gjykate e konsideron si të pabazuar për faktin se bazuar në dispozitën e nenit 68 paragrafi 1 parashihet që "Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë në bazë të paragrafit 4. të nenit 46 të këtij ligji, pala mund të kërkojë, me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin." Në rastin konkret organi administrativ, aktin administrativ e ka nxjerr para se pala paditëse të kërkojë me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë, prandaj si i tillë akti administrativ nuk mund të konsiderohet si i pas afatshëm. Pretendimi tjetër i paditësit se aktgjykimi A.nr.1337/2017 është ekzekutuar duke qenë se është në zhvillim procedura penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, për kolegjin e kësaj gjykate edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi që në procedurën e konfliktit administrativ, në bazë të nenit 43 paragrafi 1 parashihet që "Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative", ndërsa

nga aktgjykimi paraqitur nga paditësi, gjykata nuk mund ta merr për bazë të njëjtin, nëse nuk është shqyrtuar si provë në procedurën administrative të zhvilluar në organin administrativ.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. .

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1158/22, me datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova